



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

11318.

Nr. Prot.,

Tiranë, më 18.6.2020

Lënda: **Njoftim për shpallje konkurimi.**

**DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE
INTEGRIMIT EUROPIAN**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe VKM-së 921 datë 29.12.2014, i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

Përgjegjës, Sektori i Antikontrabandës Tokësore, në Drejtorinë e Antikontrabandës, Departamenti Operativo-Hetimor, Kategoria III-a/1 1 (një) vend pune.

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të ketë shtetësi shqiptare;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të gëzojë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tij;
4. Të mos ketë qenë i dënuar për krime dhe që nuk gjykohet për një çështje penale në ngarkim të tij;
5. Të mos ketë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze;
6. Arsimi i Lartë Master Shkencor në Shkencat Ekonomike, Juridike, Natyrore, të lidhura me Sigurinë dhe Hetimin, ose Akademi Ushtarake/Policore.
7. Të ketë njohuri në përdorimin e kompjuterit.
8. Të ketë përvojë pune të paktën tre vjet në pozicione të nivelit ekzekutiv.
9. Vendbanimi të jetë jo më shumë se 45 km nga vendi i punës

Avantazhe:

Njohja e një gjuhe të huaj të dyte avantazh

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

1. Vepron si Kreu i Sektorit të Antikontrabandës Tokësore dhe përgjigjet drejtpërsëdrejti para Drejtorit të Drejtorisë së Antikontrabandës. Vepron si Zyrtari Raportues për vlerësimin e veprimtarisë së postmbajtësit në përputhje me Sistemin e Vlerësimit të ngritur në SHDSH për këtë qëllim.
2. Zbaton me efikasitet dhe në kohë udhëzimet/detyrat e ngarkuara nga eprorët me kusht që të jenë në përputhje me ligjin; në rast të kundërt, ushtron të drejtën e kundërshtimit sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.
3. Administron dhe merret rregullisht me zbatimin e legjislacionit që ka të bëjë me kontrabandën, evazionin fiskal nga personeli i Drejtorisë dhe respektivisht:
4. Në bazë ditore shqyrton kërkesat e adresuara Drejtorisë për Sektorin e Antikontrabandës Tokësore.
5. Kërkon raporte të herëpashershme nga drejtuesit vartës të Sektorit dhe mban takime me drejtuesit vartës për përmirësimin e punës.
6. Siguron që të dhënat të mbledhen në mënyrë të duhur nga burimet e disponueshme dhe përpunohen sipas rregullave dhe procedurave në fuqi për këtë qëllim;
7. Identifikon nevojat për logjistikë të Sektorit; rekomandon dhe mbështet masat për përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të mbledhjes së të dhënave; bashkëpunon përkatësisht me Drejtorinë e Logjistikës.
8. Kryen detyra administrative dhe pune teknike, përfshirë planifikimin, organizimin, mbikqyrjen dhe menaxhimin e të gjitha aspekteve të punës në Sektorin e Antikontrabandës Tokësore dhe të Grupeve të Antikontrabandës Tokësore në varësi.
9. Vendos para përgjegjesisë ligjore të gjithë ata subjekte që kryejnë veprime të paligjshme për t'iu shmangur kontrollit doganor ose që kryejnë çdo lloj trafiku të paligjshëm.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim, e-mail dhe numër telefoni;
2. Curriculum Vitae (dhe letër motivimi);
3. Diplomë dhe Listë Notash të noterizuar;
4. Dëshmi Penaliteti/Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Gjykata;
6. Vërtetim nga Prokuroria;
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Fotokopje të letërnjoftimit;
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Fotokopje të kurseve kualifikuese.
12. Letër referencë dhënë nga punëdhënësi/eprori direkt i pozicionit të fundit.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër

Procedura e konkurimit do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën parakualifikuese kandidatët do të vlerësohen nga dokumentacioni i paraqitur nëse plotësohen kërkesat për konkurim. Aplikantët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë do të vijojë me kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në:

- a) Përvojën
- b) Kualifikimin
- c) Aftësitë

Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Rezultatet e konkurimit

Lista me kandidatët fitues, do të shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 29.062020, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/ Zyra e Sekretari/Protokollit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Gjon Bardhi

